



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI PËR SIGURINË KOMBËTARE

Tiranë më 17.12.2019
Dokument parlamentar

RAPORT
PËR PROJEKTVENDIMIN
“PËR PROPOZIMIN KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR
DHËNIEN E PËLQIMIT PËR ZGJATJEN E GJENDJES SË FATKEQËSISË
NATYRORE”

- *Hyrje*

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, bazuar në nenet 32-36 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit përgjegjës, shqyrtoi në mbledhjen e datës 16.12.2019 në parim, nën për nen dhe në tërësi, projektvendimin “*Për propozimin Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për dhënien e pëlqimit për zgjatjen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore*”.

Për të prezantuar projektvendimin në komision ishin të pranishëm Zëvendësministri i Mbrojtjes, Z.Petro Koçi dhe Drejtori i Agjencisë Kombëtare për Mbrojtjen Civile, Z.Haki Çako.

Relator për shqyrtimin e projektvendimit u caktua deputeti Sadi Vorpsi.

- *Baza kushtetuese e projektligjit*

Projektvendimi është hartuar në mbështetje të neneve 100 e 174, të Kushtetutës, dhe të nenit 18, të ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”.

- *Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e projektligjit*

Në mëngjesin e datës 26 nëntor 2019 u regjistrua një ndër tërmetet më të fuqishme të dekadave të fundit, me magnitudë $M_g=6.3$ shkalla Rihter, në thellësi 38 km dhe me epiqendër 15 km në veri të qytetit të Durrësit.

Për përballimin e situatës së krijuar nga tërmeti është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore me vendimin nr.750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë” dhe me vendimin nr.751, datë 29.11.2019, të Këshillit të Ministrave është përfshirë dhe Qarku Lezhë.

Vendimi nr.750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, ai i shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, kishte si pikë të veçantë ngritjen e Komitetit Ndërmnistror të Emergjencave Civile, i cili përgatiti një program pune të detajuar për përballimin e situatës së krijuar nga tërmeti.

Për sa i përket kohëzgjatjes maksimale të gjendjes së fatkeqësisë natyrore, neni 174, i Kushtetutës, parashikon një periudhë maksimale 30-ditore, në bazë të së cilës është shpallur gjendja e fatkeqësisë, që në rastin konkret është krijuar nga tërmeti i datës 26.11.2019.

Ligji i mbrojtjes civile parashikon se gjendja e fatkeqësisë natyrore kalon në disa faza, të cilat fillojnë me ndodhjen e fatkeqësisë natyrore, vijon me fazat e kërkim-shpëtimit, verifikimit e pasojave dhe fazën finale të rregullimit të pasojave nëpërmjet rindërtimit.

Duke pasur parasysh se gjatë 30 ditëve të para pas tërmetit të datës 26.11.2019 përfundoi faza e kërkim-shpëtimit dhe filloi faza e verifikimit, përfundimi i fazës së verifikimit, hartimi dhe zbatimi i masave afatshkurtra të rregullimit të pasojave me qëllim sigurimin e jetës dhe të shëndetit të individëve është baza e nevojës për zgjatje të afatit të gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë, Lezhë.

Qëllimi i këtij projektvendimi është zgjatja deri në datën 31 mars 2020 e gjendjes së fatkeqësisë natyrore, në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë, shpallur me vendimin nr.750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Lezhë dhe Tiranë”, të ndryshuar. Gjendja e fatkeqësisë natyrore, e cila shoqërohet me marrjen e masave të jashtëzakonshme në këto qarqe, sipas vendimit të shpalljes përfundon përkatësisht në datat 28 dhe 30 dhjetor 2019.

Objektivat e këtij projektvendimi janë:

- garantimi i sigurisë së jetës së banorëve;
- sigurimi i veprimtarisë normale për jetesën e komuniteteve të prekura në këto zona;
- marrja e masave parandaluese, mbrojtëse e rehabilituese në infrastrukturën dhe mjedisin e prekur nga situata e krijuar.

- ***Diskutime***

Në fjalën e tij zoti Koçi bëri një përmbledhje të situatës së deritanishme të punës dhe të dëmeve të konstatuara në tre qarqet në të cilat është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore.

Në vijim, ai shpjegoi se përse nevojitet një afat shtesë për gjendjen e fatkeqësisë natyrore duke vënë theksin tek nevoja për të rekuperuar çdo dëm material.

Mandej fjalën e mori relatori, zoti Vorpsi i cili falenderoi punën e bërë deri tani nga Komiteti Ndërmintor dhe Shtabi i Emergjencave Civile si dhe nga institucionet përgjegjëse përsa i përket masave të ndërmarra dhe gadishmërisë së tyre në menaxhimin e situatës së krijuar menjëherë pas tërmetit.

Në vijim anëtarë të komisionit shtruan pyetje dhe diskutime në çështje si:

- shtrirje të inspektimeve edhe në qarqe të tjera të cilat kanë patur dëme nga tërmeti edhe pse jo në masën e tre qarqeve kryesore, Durrës, Tiranë, Lezhe;
- vënien në dispozicion të sa më shumë pikave të informacionit dhe numrave të telefonit për qytetarët në mënyrë që të mund të kenë informacione në kohë reale;
- shmangien e burokracive në lidhje me verifikimet/inspektimet apo plotësimin e dokumentacionit që nevojitet për përfitimin e strehimit apo ndihmës në ushqim apo veshmbathje, etj.

- ***Riformulime***

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, pas pyetjeve dhe diskutimeve, me shumicën e votave të anëtarëve prezent në mbledhje, miratoi projektvendimin duke e riformuluar sipas tekstit të mëposhtëm:

“Për dhënien e pëlqimit për zgjatjen e afatit të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shpallur me Vkm nr.750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”, të ndryshuar””, deri në datën 31.3.2020”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren Zyrtare”.

- ***Përfundim***

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, pasi e shqyrtoi projektvendimin në parim, nën për nën dhe në tërësi, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje e miratoi atë dhe vendosi t’ia kalojë për miratim seancës plenare, duke vlerësuar se:

- ***Në aspektin ligjor***, projektvendimi i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.
- ***Në aspektin procedural***, projektvendimi është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Relator

Sadi VORPSI

Kryetar

Ermonela (Felaj) VALIKAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument Parlamentar

Tiranë, më 16.12.2019

RAPORT

PËR PROPOZIMIN KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË “PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR ZGJATJEN E GJENDJES SË FATKEQËSISË NATYRORE”

- Hyrje

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 16.12.2019, mori në shqyrtim propozimin e Këshillit të Ministrave të miratuar me vendimin nr. 810, datë 13.12.2019, drejtuar Kuvendit të Shqipërisë “Për dhënie e pëlqimit për zgjatjen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relator për shqyrtimin e këtij propozimi deputetin Edmond Leka.

I. BAZA KUSHTETUESE DHE LIGJORE E PROPOZIMIT PËR DHËNIE PËLQIMI PËR ZGJATJEN E GJENDJES SË FATKEQËSISË NATYRORE”

Neni 174 i Kushtetutës parashikon se:

“1. Për parandalimin ose mënjanimin e pasojave të një fatkeqësie natyrore ose aksidenti teknologjik, Këshilli i Ministrave mund të vendosë, për një periudhë jo më të gjatë se 30 ditë, gjendjen e fatkeqësisë natyrore në një pjesë ose në të gjithë territorin e shtetit.

2. Zgjatja e gjendjes së fatkeqësisë natyrore mund të bëhet vetëm me pëlqimin e Kuvendit.”

Referuar nenit 175 të Kushtetutës:

“2. Gjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore mund të kufizohen të drejtat dhe liritë e parashikuara nga nenet: 37, 38, 41 paragrafi 4, 49, 51.

3. Aktet për shpalljen e gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme ose të gjendjes së fatkeqësisë natyrore duhet të cilësojnë të drejtat dhe liritë që kufizohen.”

Nenet 18 dhe 39 i ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, parashikojnë që:

Neni 18 shkronja “d”

“Këshilli i Ministrave miraton dhe siguron zbatimin e politikave për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile në Republikën e Shqipërisë dhe ka këto përgjegjësi:

d) informon Kuvendin e Republikës së Shqipërisë nëpërmjet ministrit për situatën e krijuar, rreziqet që paraqiten dhe masat e marra për menaxhimin e situatës, si dhe kërkon miratimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për zgjatjen e gjendjes së fatkeqësisë përtej 30 ditëve.”

“Neni 39

1. Këshilli i Ministrave mund të vendosë, për një periudhë jo më të gjatë se 30 ditë, gjendjen e fatkeqësisë natyrore në një pjesë ose në të gjithë territorin e vendit.

2. Zgjatja e gjendjes së fatkeqësisë natyrore, sipas përcaktimit të bërë në pikën 1, të këtij neni, mund të bëhet vetëm me miratimin e Kuvendit.”

II. QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROPOZIMIT

Nëpërmjet VKM nr. 750, datë 27.11.2019, i ndryshuar me VKM nr. 751, datë 29.11.2019, Këshilli i Ministrave ka shpallur gjendjen e fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Lezhë dhe Tiranë, si pasojë e dëmeve të shkaktuara nga tërmeti i datës 26.11.2019, për një periudhë jo më të gjatë se 30 (tridhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

VKM e sipërcituar parashikon krijimin e Komitetit Ndërministror të Emergjencave Civile (KNEC), si organi më i lartë për koordinimin dhe bashkërendimin e veprimeve të institucioneve shtetërore dhe të subjekteve private, si dhe të burimeve financiare e materiale për përballimin e fatkeqësisë natyrore, i cili përgati një program të detajuar pune për përballimin e situatës së krijuar nga tërmeti.

Ky vendim ka parashikuar njëkohësisht edhe masat që duhet të merren gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore nga: institucionet publike; strukturat operationale të sistemit të mbrojtjes civile; subjektet private dhe shtetëtasit gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së jashtëzakonshme.

Nga tërmeti i datës 26.11.2019 rezulton se qarqet më të prekura janë: Durrësi, Tirana dhe Lezha. Sipas informacion zyrtar që shoqëron këtë propozim rezulton se:

- Për Qarqet Tiranë dhe Durrës janë dëmtuar rëndë: 2002 banesa; 135 pallate dhe 60 pallate janë shpallur të pabanueshme. Ndërkohë rezulton se 4380 pallate dhe 543 banesa janë të dëmtuara lehtë.
- Për Qarkun Lezhë janë dëmtuar rëndë 1353 apartamente; 235 vila dhe 66 pallate. 45 pallate, 559 apartamente dhe 181 vila janë me dëmtime të mesme si dhe 263 pallate dhe 1297 apartamente dhe 57 vila janë me dëmtime të lehta.

Përsona të evakuar, strehuar në hotele, çadra, qendra sociale dhe familje rezulton të jenë 3224 persona prej të cilëve: 1961 të strehuar në hotele; 964 në çadra; 867 në qendra sociale dhe 2525 në familje.

Për sa i takon kohëzgjatjes maksimale të gjendjes së fatkeqësisë natyrore, Kushtetuta dhe ligji 45/2019 “Për mbrojtjen civile” parashikojnë një kohëzgjatje maksimale prej 30 ditësh. Duke mbajtur në konsideratë që gjatë 30 ditëve të para përfundoi faza e kërkim-shpëtimit dhe filloi faza e verifikimit të dëmeve, nevoja për përfundimin e fazës së verifikimit si dhe hartimit dhe zbatimit të masave afat-shkurtra të rregullimit të pasojave me qëllim sigurimin e jetës dhe shëndetit të individëve, vlerësohet si shkak i nevojshëm për të propozuar zgjatjen e afatit të gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë deri më 31.3.2020.

Njëkohësisht në vlerësim të propozuesit, veprimtaria e strukturave operationale dhe nevoja e marrjes së masave në kuadër të gjendjes së fatkeqësisë natyrore është emergjente si në ditët e para të marrjes së masës. Kjo pasi vetëm gjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore mund të merren vendimet e mëposhtme:

- strukturat operationale dhe drejtuesit e tyre (Ushtria, policia, zjarrfikësit, emergjenca mjekësore) janë në dispozicion të KNEC-së;

- mund të vendosen dhe të zbatohen masa të jashtëzakonshme për përballimin dhe lehtësimin e pasojave të fatkeqësisë, si ndaj institucioneve publike, qëndrore dhe vendore, ashtu edhe ndaj privatëve përfshirë edhe gjopa në rast të moszbatimit të këtyre masave;
- kryhet zyrtarisht apeli për asistencë, drejtuar organizmave ndërkombëtare dhe shteteve të tjera, kërkesat e specifikuar për nevojat për asistencë dhe raportet periodike të situatës për Qendren Evropiane të Koordinimit të Emergjencave, për Qendrën Euroatlantike të Koordinimit të Përgjigjes për Fatkeqësitë;
- mediat dhe organet e tjera të informimit publik janë të detyruara t'u referohen burimeve zyrtare për njoftime lidhur me numrin e viktimave, listën e emrave dhe të parashikimeve të metejshme për mundësinë e ndodhjes së ngjarjeve të tjera, duke shmangur transmetimin e informacioneve sensitive, si dhe duke mos krijuar panik te publiku, në asnjë rast;
- autoritetet mund të vendosin gjopa nga 100 000 (njëqind mijë) - 500 000 (pesëqind mijë) lekë ndaj bashkive, subjekteve private dhe shtetasve nëse nuk përmbushin detyrimet.

Në përfundim të shqyrtimit të këtij propozimi, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

Në aspektin ligjor, propozimi drejtuar Kuvendit të Shqipërisë “Për dhënien e pëlqimit për zgjatjen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore” është i mbështetur në nenin 174 pika 2 të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, me votat e të gjitha anëtarëve të pranishëm e miratoi atë dhe u shpreh dakord për kalimin për votim në seancë plenare.

RELATOR

KRYETARI

EDMOND LEKA

ULSI MANJA